



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1123/11 prot.

Datë 01.06.2026

V E N D I M

Nr. 732/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76785 02-19-2026, me objekt “Mirembajtje pajisje elektronike”, me fond limit 1,416,666.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

Ankimues: Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, me Nipt. L81506043D Adresa: Rr. Ali Demi perballe Fushes se Zeze zona kadastrale 8150, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlore. Adresa: Sheshi “4 Heronjtë” Vlore, 9400.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021,

datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20-02-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76785 02-19-2026, me objekt “Mirembajtje pajisje elektronike”, me fond limit 1,416,666.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

II.2. Në datën 09.03.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 19-03-2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|----------------------------|--------------------------------------|
| 1. OE “INSTANT.AL” SH.P.K, | me vlerë 1,066,666 lekë skualifikuar |
| 2. OE “IT STORE” SH.P.K, | me vlerë 1,120,000 lekë kualifikuar |

II.4. Në datën 08.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6510, datë 10.04.2026 dhe me nr. protokoli 1123/2026 datë 10.04.2026 e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76785-02-19-2026, me objekt “Mirembajtje pajisje elektronike”, me fond limit 1,416,666.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1123/1 prot., datë 15.04.2026. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.7316/8 prot., datë 16.04.2026, protokolluar me tonën me nr.1123/2 prot., datë 17.04.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin në lidhje me ankesën e OE “INSTANT” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e OE “INSTANT.AL” SHPK, ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e ankesës. Gjithashtu shkresa me nr.7316 datë 16.04.2026 është përcjellë nëpërmjet postes nga autortiteti kontraktor dhe protokolluar me tonën me nr.1123/3, datë 20.04.2026 në përmbajtje të së cilës rezulton trajtimi i ankesës së OE “INSTANT.AL” SHPK, ankimues ku në përfundim është vendosur refuzimin i ankesës.

II.8. Me shkresën nr. 1123/4 prot., datë 28.04.2026, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor mbi detyrimin e këtij të fundit për dhënie të dokumentacionit në KPP-së lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitura nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK me qëllim vijimin e trajtimit të ankesës së këtij të fundit në KPP.

II.9. Me shkresën nr. 8376/1 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1123/5 prot., datë 07.05.2026 është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacionit kopjet e pa noterizuar të tyre, të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “INSTANT” Shpk., për përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor të parashikuara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe kriterëve të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.10. Me shkresën nr. 1123/6 prot., datë 13.05.2026, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor mbi detyrimin e këtij të fundit për dhënie të dokumentacionit origjinal / kopjet e noterizuar të tyre në KPP-së për trajtimin e ankesës të paraqitura nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.

II.11. Me anë të shkresës datë 20.05.2026, operatori ekonomik ankimues “Instant” SHPK ka dorëzuar listën e dorëzimit të dokumentacionit të administruar nga autoriteti kontraktor, protokolluar me tonën me nr. 1123/7 prot., datë 21.05.2026.

II.12. Me shkresën nr. 9598/1 prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1123/8 prot., datë 25.05.2026 është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacionit origjinal / kopjet e noterizuar të tyre, të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “INSTANT” Shpk., për përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor të parashikuara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe kriterëve të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “INSTANT” SHPK, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tyre, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, duke argumentuar se: *“Mbi provën për mungesën e çështjeve penale/civile dhe gjendjen e subjektit Operatori ekonomik ka paraqitur vërtetim nga Gjykata për ortakun/administratorin dhe për vetë shoqërinë INSTANT.AL shpk, nga i cili*

rezulton se nuk ka çështje penale dhe civile. Për më tepër, është paraqitur edhe Dëshmia e Penalitetit, e cila provon mungesën e dënimeve penale sipas legjislacionit në fuqi. Ligji nr. 162/2020 Për prokurimin publik, i ndryshuar me Ligjin 16/2024, parashikon kriteret detyruese të skualifikimit në nenin 76, ndërsa parimi i provës paraprake me formularin përmbledhës të vetëdeklarimit është sanksionuar në nenin 82. Sipas këtij neni, autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake formularin e vetëdeklarimit, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta. Po kështu, neni 26 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përcakton se bashkë me ofertën autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe se në të deklarohet, ndër të tjera, që operatori ekonomik dhe personat me kompetenca përfaqësuese/vendimmarrëse nuk janë dënuar për veprat e nenit 76 të LPP-së. Pra, edhe sikur autoriteti të çmonte se kërkohej verifikim shtesë, dokumentet e paraqitura nga shoqëria janë jo vetëm që ekzistojnë, por shkojnë edhe përtej standardit minimal të provës paraprake të lejuar nga ligji. Për rrjedhojë, pretendimi për mungesë dokumentacioni mbi këtë pikë është i pasaktë.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca9 “Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit”, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----

Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare:	-----
Qyteti / qyteti; Kodi postar	
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata			
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.			
<i>Sqarimenëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.			
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____			
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:			

etj.			
nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.			
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____			

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime</i> <i>nëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i> _____				
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime</i> <i>nëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i> _____				
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime</i> <i>nëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i> _____				
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime</i> <i>nëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i> _____				
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet</i> <i>nevojshme</i>_____				
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____				
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.				

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;

metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;

qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të

zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:
	Profili i punonjësve
	<u>Makineri e mjete</u>
	Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Emri, Mbiemri_____

Firma_____

Vula_____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

III.1.2. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket “Vërtetimit nga Prokuroria (për Subjektin dhe Administratorin)”, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT” SHPK pranë autortitetit kontraktor, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur si më poshtë:

-Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve , Sektori i gjendjes gjyqësore nr.11 prot., datë 03.03.2026 për subjektin “Instant” SHPK ku ndër të tjera rezulton se subjekti është i padënuar, vulosur elektornikisht.

-Vërtetim i gjendjes gjyqësore nga Ministria e Drejtësisë , Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nr.11, datë 23.03.2026 ku rezulton se shtetasi E.GJ, është i padënuar, vulosur elektornikisht.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.1.4. Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës...”*

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një*

ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; 10 h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.9. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për sa i përket Vërtetim nga Prokuroria (për Subjektin dhe Administratorin) të operatorit ekonomik ankimues “Instant” SHPK, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në fjalë rezulton, se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “A” “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, është deklaruar: *“Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.”*, si dhe *“Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:etj, nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.”*. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar fizikisht në AK rezulton ashtu sikurse cituar në pikën III.1.2 të këtij vendimi, se operatori ekonomik ankimues “INSTANT” SHPK ka dorëzuar dëshmitë e penalitetit si për administratorin dhe për subjektin tregtar sipas kërkesave të vetë autoritetit kontraktor. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Instant” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar formulari i përgjithshëm i vetëdeklarimit, si dhe vërtetimet në funksion të tij të dorëzuar në autoritet, ku rezulton i padënuar si administratori ashtu dhe subjekti tregtar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Instant” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “INSTANT” SHPK, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tyre, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, duke argumentuar se: *“Mbi certifikimet ITIL ose ekuivalente Në dokumentacionin e ofertës janë paraqitur certifikatat për stafin Granit Gjana, Dionis Sheti dhe Xheni Hoxhallari, në fushën ITIL ose ekuivalente, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit. Përderisa kërkesa e autoritetit kontraktor është formuluar si ITIL ose ekuivalente , çdo vlerësim duhet të bëhet sipas parimit të proporcionalitetit, konkurrencës së hapur dhe pranimi të ekuivalencës, dhe jo në mënyrë formale ose kufizuese. Ligji i prokurimit publik në fuqi dhe kuadri nënligjor kërkojnë që kriteret e kualifikimit të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe të vlerësohen sipas përmbajtjes reale të provës së paraqitur. Për sa kohë certifikatat për personat e sipërcituar janë dorëzuar, arsyeja e skualifikimit për këtë element bie poshtë në fakt. IV. Mbi deklaratën për disponimin e punonjësve Edhe kjo arsye nuk qëndron. Deklarata për disponimin e punonjësve të kërkuar është përfshirë dhe plotësuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Neni 82 i LPP-së parashikon shprehimisht se formulari i vetëdeklarimit pranohet si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve, ndërsa neni 26 i VKM nr. 285/2021 përcakton përmbajtjen e këtij formulari dhe përdorimin e tij nga autoriteti*

kontraktor gjatë fazës së paraqitjes së ofertës. Kjo do të thotë se, në fazën e ofertimit, operatori ekonomik ka të drejtë të vetëdeklarojë disponueshmërinë e burimeve njerëzore sipas formatit standard të miratuar, pa qenë nevoja për të shumëfishuar deklaratime paralele me të njëjtin përmbajtje, për aq kohë sa DST nuk kërkon një format tjetër të posaçëm dhe të veçantë. Për pasojë, pretendimi se mungon deklarata për disponimin e punonjësve është i pabazuar, pasi kjo është pasqyruar në formularin standard që vetë legjislacioni e njuh si provë paraprake të vlefshme.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, e procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguruar 3 (tre) muajt e fundit, si dhe gjatë vlefshmërisë së kontrates, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në degët e Inxhinierive Informatike (IT) që do të angazhohen në implementimin e mirëmbajtjes, si më poshtë:

a. 3 (tre) specialistë të certifikuar nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë për disponimin e punonjësve të përmendur në këtë pikë
- Certifikata përkatëse/ Transkriptet përkatëse
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi.
- Kontrata pune, për secilin nga punonjësit e përmendur në këtë pikë, të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.”

-Gjithashtu në shtojcën 9 të DST-së është kërkuar si më poshtë :

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e	Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:

kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	_____
	Profili i punonjësve

	<u>Makineri e mjete</u>
	Po [] Jo []
	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

III.2.2. Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa i përket kriterit 2.3.2, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT” SHPK ne sistemin e prokurimeve elektronike ashtu dhe fizikisht pranë autoriteti kontraktor, konstatojmë se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar:

-Specialistë për këtë procedurë sipas kërkesave në pikën 2.3.2:

-G.Gj

-D.Sh

-Xh.H

Sipas dokumentacionit fizik të dorëzuar në AK në funksion të formularit të vetëdeklarimit konstatohen certifikimet si më poshtë:

-G.Gj (People Cert “Certifikatë e fondacionit ITIL në menaxhimin e shërbimit IT”)

-D.Sh (CISCO Academy “Certifikatë e përfundimit të kursit hyrje së sigurinë kibernetike”

-Xh.H (ASHP “Certifikatë e kursit të formimit profesional Sherbime IT”)

III.2.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët

ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: “2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguruar 3 (tre) muajt e fundit, si dhe gjatë vlefshmërisë së kontrates, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në degët e Inxhinierive Informatike (IT) që do të angazhohen në implementimin e mirëmbajtjes, si më poshtë:

- a. 3 (tre) specialistë të certifikuar nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë:

• **Deklaratë për disponimin e punonjësve të përmendur në këtë pikë**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjësit e kërkuara në pikën 2.3.2. të kriterëve të veçanata të kualifikimit, operatori ekonomik ankimues “Instant” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme se ka mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.2.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimuesi ka deklaruar: 11 punonjës në total sipas si më poshtë:

1.G.GJ

2. D.SH

3. Xh.H

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “h” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: h) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti. Dhe përsa i perket pretendimit të operatorit për deklarimin e punonjësve sipas kriterit 2.3.2 ajo është përmbushur nga operatori ekonomik ankimues ashtu sic cituar në pikën III.2.2 të këtij vendimi dhe rrjedhimisht pretendimi i operatorit qëndron lidhur me deklarimin për disponimin e punonjësve, prandaj autoriteti kontraktor në rivlerësimin e procedurës duhet të heqë këtë arsye skualifikimi për operatorin ekonomik ankimues.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Instant” SHPK qëndron.

- Nisur nga arsyet tjetër e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: - 3 (tre) specialistë të certifikuar nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent ...

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë:

...

• **Certifikata përkatëse/ Transkriptet përkatëse**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht sikurse paraqitet edhe në pikën III.2.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimuesi ka deklaruar: 11 punonjës, nga të cilët për pikën a. 3 specialist, nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent, ka deklaruar:

-G.Gj.(People Cert “Certifikatë e fondacionit ITIL në menaxhimin e shërbimit IT”)

-D.Sh. (CISCO Academy “Certifikatë e përfundimit të kursit hyrje së sigurinë kibernetike”

-Xh.H. (ASHP “Certifikatë e kursit të formimit profesional Shërbime IT”).

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimes nëpërmjet certifikatave të dorëzuar e nuk e përmbush plotësisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për kriterin të 3 specialist, të certifikuar nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent, pasi ashtu vetëm për punonjeshin G.GJ është paraqitur certifikata ITIL në menaxhimin e shërbimit IT nga 3 specialiste të tilla të kërkuar. Për 2 specialistët e tjerë të deklaruar D.Sh dhe Xh.H nuk është paraqitur certifikimi i kërkuar dhe akoma më tej certifikimet e dorëzuara nga Operatori ekonomik ankimes nuk i përkasin ekuivalencës së menaxhimit të shërbimit IT. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimes nëpërmjet certifikatave të dorëzuar e nuk përmbush plotësisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për kriterin 3 (tre) specialistë të certifikuar nga ITIL për menaxhimin e shërbimeve të IT, ose ekuivalent.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Instant” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Instant” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre me pretendimin se : *“Vërtetim/kthim përgjigje nga APP se operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.” Kjo arsye është gjithashtu e pambështetur ligjërisht. Neni 78 i Ligjit nr. 162/2020 parashikon se Agjencia e Prokurimit Publik përjashton operatorët ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë të caktuar, ndërsa vetë APP publikon listën e operatorëve të përjashtuar. APP mban publikisht në faqen e saj zyrtare listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik , e cila është e aksesueshme për autoritetet kontraktore dhe publikun. Po kështu, Programi i Transparencës / Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve i APP-së tregon se lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar është informacion publik. Për rrjedhojë, kërkesa për një kthim përgjigje nga APP si dokument më vete nuk gjen mbështetje në logjikën e nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr. 285/2021, për sa kohë verifikimi mund dhe duhet të bëhet nga vetë autoriteti kontraktor në burimin publik zyrtar. Në këtë kuadër, mjafton deklarimi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit se operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e nenit 78, ndërsa verifikimi i mëtejshëm nga autoriteti kontraktor mund të kryhet përmes burimeve publike të APP-së. Kërkimi i një shkrese të posaçme nga APP, kur lista është publike dhe e verifikueshme online, përbën formalizëm të tepruar dhe bie ndesh me parimin e proporcionalitetit., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Referuar shkresës nr. 9598/1 prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1123/8 prot., datë 25.05.2026 me objekt “Informacion” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Instant” SHPK ku ndër të tjera vërehet dhe formulari përmbledhës i vetëdeklarimit sipas dokumentave të tenderit. Lidhur me rubrikën Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT 13 A: DEKLARATA PËR

PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT ... *Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi ka deklaruar si poshtë vijon:*

-Sqarime nëse vlerësohet nevojshme “(Deklaroj që Instant.al Shpk nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka cuar në perfundimin e kësaj kontrate. Provohet nga Vertetimi i Mosperjashtimit nga APP)”.

III.3.2. Në nenin 77 pika 1, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.3. Në nenin 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: 1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese,

vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij. 2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur: a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi; b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh; ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës. 3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë; b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji; c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi; ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën; d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja; e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji. ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit; f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e

vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin. g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. 4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni. 5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raportin në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji. 6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë. 7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.3.4. Në nenin 78 “Përjashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: 1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi; b) mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik; c) nëse është tërhequr mbi pesë herë nga nënshkrimi i kontratës në procedura prokurimi të ndryshme, të zhvilluara nga një ose disa autoritete ose ente të ndryshme kontraktore brenda një viti kalendarik; ç) kur ka një vendim të formës së prerë të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta. 2. Agjencia e Prokurimit Publik merr vendime për përjashtimin e

operatorëve ekonomikë, duke mbajtur parasysh parimet e paanshmërisë, ligjshmërisë dhe proporcionalitetit. 3. Rregullat dhe afatet që ndiqen në procesin e përjashtimit përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

III.3.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”

III.3.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë,

të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.3.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor

janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 6 të nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "6.Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. ndërsa në pikën 2 të nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet, se "Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës".

III.3.8. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik "Instant" SHPK, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ky i fundit, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, është dorëzuar Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit (shtojca 8), ku janë plotësuar të gjitha të dhënat që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht Deklaratën "Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT". Gjithashtu konstatohet se për kërkesat se "Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate" dhe "Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.", operatori ekonomik "Instant" SHPK, në ankesën e bërë deklaron se informacioni për verifikimin e këtij deklarimi gjendet në publikisht në faqen e saj zyrtare listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik , e cila është e aksesueshme për autoritetet kontraktore dhe publikun në faqen ëëë.app.gov.al. Nisur nga pretendimet e ankimuesit, dhe verifikimit të dokumentacionit, operatori ekonomik ka deklaruar informacion e kërkuar, në kuptim të nenit 76, 77 dhe 78 të Ligjit 160/2020 "Për Prokurimin

Publik”, i ndryshuar, së pari KPP, vëren se operatori ekonomik “Instant” SHPK, ka plotësuar Formularin Përmbledhës së Vetëdeklarimit, ku konstatohet se janë plotësuar të gjitha rubrikat përkatëse, “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT”. Gjithashtu, referuar deklarimeve të operatori ekonomik “Instant” SHPK, nga verifikimi në faqen zyrtare www.app.gov.al, rezulton se ky i fundit nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar, në momentin e zhvillimit të procedurës. Sa më sipër, referuar deklarimeve të mësipërme të operatorit ekonomik “Instant” SHPK, si dhe verifikimit në faqen eeb të Agjencisë së Prokurimit Publik, si organi përgjegjës i cili përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, në rast keqinformimi dhe dorëzimi të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi; apo mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik, etj, operatori ekonomik “Instant” SHPK, nuk rezulton i përjashtuar nga procedurat e prokurimit publik, rrjedhimisht nuk është në asnjë prej kushteve për skualifikim siç pretendon autoriteti kontaktor, pasi operatori ekonomik ankimues ka deklaruar se nuk ka shfaqur mangesi të rendesishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të meparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në perfundimin e kësaj kontrate akoma me tej autoriteti kontaktor mund të kryente nëpërmjet adresës këtë verifikimi për një fakt të tillë ose akoma me tej të kërkonte sqarime operatorit ekonomik ankimues.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76785 02-19-2026, me objekt “Mirembajtje pajisje elektronike”, me fond limit 1,416,666.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK sipas konstatimeve të vendimit të Komisionin e Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersin

Nënkryetar

Fiorent Zguro

